



Bazuar në Planin Hapsinorë të Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemura”, në të cilin përfshihen si Zona zhvillimore –në Zonën e Tretë, Pronat e shpallura me interes publik me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Deçanit, Nr.12244, dt.30.04.2021, në bazë të pikës d) të paragrafit 1.3 të kapitullit V-të, të dispozitave për zbatim të Planit Hapësinor të PK “Bjeshkët e Nemura”, Në bazë të nenit 10, nenit 11 dhe nenit 17 të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja (d) dhe nenin 17 shkronja ( b) të Ligjit nr. 03/L – 040, për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/2008), dhe nenit 15 pika 2 të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019, Me Rekomandim të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, të dt.08.02.2024, nr.383-2/24, për Rishqyrtim të ligjshmërisë së Aktit, Vendimi 01.Nr.XI-8 për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm (PRRH), për pronat e shpallura me interes publik në Parkun Kombëtar “Bjeshkët Nemura”i miratuar me dt.29.12.2023, Kuvendi i Komunës së Deçanit, në mbledhjen e mbajtur me dt.29.03.2024, nxjerrë këtë :

## VENDIM

### PËR HARTIMIN E PLANIT RREGULLUES TË HOLLËSISHËM (P.RR.H.) PËR PRONAT E SHPALLURA ME INTERES PUBLIK NË PARKUN KOMBËTAR “BJESHKËT NEMURA”

#### Neni 1

Merret Vendimi për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm (PRRH), për pronat e shpallura me interes publik në Parkun Kombëtar “Bjeshkët Nemura”

#### Neni 2

Plani Rregullues i Hollësishëm (PRRH) për pronat e shpallura me interes publik në Parkun Kombëtar “Bjeshkët Nemura” përfshinë hapësirat, sipas Planit Hapësinorë të Parkut Kombëtarë “Bjeshkët e Nemura”, Zona e Tretë Zhvillimore.

-Qendra Turistike dimërore dhe verore në Bjeshkën e Belegut, me sipërfaqe 125 ha.

-Qendra e Skijimit në Dervishkom, me sipërfaqe 25.1 ha.

-Kampingu (Fshati Ekologjik) “Laku i Kryqës”, me sipërfaqe 63.7 ha.

#### Neni 3

Qëllimi i nxjerrjes dhe miratimit të këtij Plani, sipas këtij Vendimi është promovimi i zhvillimit dhe planifikimit racional hapësinorë, harmonizimi i drejtë peshimit në mes të zhvillimit dhe ruajtjes së sipërfaqeve të hapura , mbrojtjes së mjedisit dhe krijimit të rexhimit të planifikimit hapësinorë në përputhje me standartet ndërkombëtare, si dhe arritjen e caqeve afatgjata të zhvillimit ekonomik dhe shoqërorë të komunës së Deçanit.

#### Neni 4

***Autoriteti përgjegjës komunal (Drejtoria e Urbanizmit) përpos përgjegjësive nga baza ligjore në fuqi, sipas Dispozitave të parapara në PHPK “BN” (pikën d e paragrafit 1.3.) është përgjegjës edhe për aprovimin e Planeve Rregulluese të Hollësishme dhe zgjidhjeve urbane të propozuara nga investitori, pasi paraprakisht të paiset me pëlqim nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;***



## Neni 5

*Plani Rregullues i Hollësishëm do të hartohet në përputhje me qëllimet, objektivat dhe dispozitat për zbatim të parapara në Planin Hapësinor të PK "Bjeshkët e Nemura", duke përfshirë edhe objektivat zhvillimore të parapara në dokumentet relevante komunale që nuk janë në kundërshtim me Planin Hapësinor të PK "BN".*

## Neni 6

Hartimi i Planit Rregullues për pronat e shpallura me interes publik në Parkun Kombëtar "Bjeshkët Nemura", do të bëhet sipas procedurës së paraparë ligjore.

## Neni 7

Bartësi i hartimit të planit sipas nenit 1 të këtij vendimi është i obliguar që planin ta hartoj në afat kohor prej 3(tre) muajve,

## Neni 8

Projekt plani duhet të vihet në shqyrtim publik. Paraqitja e Planit në shqyrtim publik dhe koha për dhënien e vërejtjeve dhe komenteve për shqyrtim do të shpallen në mjetet e informimit publik.

## Neni 9

Hartimi i Planit Rregullues për pronat e shpallura me interes publik në Parkun Kombëtar "Bjeshkët Nemura" në aspektin procedural do të mbikëqyret nga Komuna, po ashtu edhe shpenzimet e realizimit të këtij projekti do të bartë Komuna e Deçanit.

## Neni 10

Plani hartohet për periudhën kohore se paku 5 (pese) vjeçare.

## Neni 11

Elaborati i planit sipas nenit 1 të këtij vendimi duhet të hartohet në 5 kopje origjinale, fizike dhe elektronike.

## Neni 12

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinorë e komunës së Deçanit.

## Neni 13

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet: Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, MPHMM, Kryetarit të Komunës, Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinorë dhe Arhivit.

01.Nr.III-3/1

Deçan, dt. 29.03.2024

## KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

Kryesuesi i Kuvendit  
Hajdar SUTAJ

